



FASONI, INTERES NGA GJERMANËT

Nga Laura ÇELA

Interesi i kompanive gjermane ndaj fasonit shqiptar po rritet. Kompania "Logwin", aktive në logjistikë, sapo ka mbërritur në Shqipëri, me qëllimin për të takuar nga afër drejtues të ndërmarrjeve që punojnë me material porosites dhe për të nisur bashkëpunimin me to. Kryetari i Dhomës së Fasonistëve të Shqipërisë, Gjergji Gjika, ka shpjeguar në seminarin e zhvilluar me 28 përfaqësues ndërmarrjesh dhe përfaqësuesin e kompanisë gjermane, në bashkëpunim me GIZ (programin gjerman të zhvillimit ekonomik dhe nxitjes së punësimit) se kjo kompani po operon prej vitesh shumë suksesshëm në rajon dhe Shqipëria duket se është "destinacioni" i fundit për të.

"Vetëm në Maqedoni, kjo kompani mban me punë thujt gjysmën e ndërmarrjeve të fasonit, rreth 105 dhe gjithashtu rreth 27 mijë të punësuar", thotë Gjika. "Logwin" është një kompani logjistike, e cila grumbullon kërkesat e klientëve gjermanë dhe i sjell në ndërmarrjet e rajonit. Më parë i bën një përpunim atyre dhe i dërgon për t'u përpunuar. Në fazën e fundit është sërish "Logwin" që merr sasisë në ndërmarrjet e rajonit dhe i çon ato drejt kompanive gjermane.

"Kjo bën të mundur që në ndërmarrjet shqiptare të vijnë porosi të mëdha, duke punësuar kështu shumë njerëz", shpjegon kreu i Dhomës së Fasonistëve. Kompania gjermane synon të operojë brenda një zone logjistike Tiranë-Durrës-Elbasan-Berat, ku është fokusuar edhe numri më i madh i ndërmarrjeve të

fasonit në vend, por që njëherësh kombinon me interesat e rajonit, si pasojë e afërsisë gjeografike.

Kriza në vendet e Lindjes së Mesme si dhe rritja e kostove të vazhdueshme në Europë ka nxitur gjithnjë e më shumë industrialistë të huaj që të kërkojnë partnerë në rajon, sidomos në Shqipëri, që ka edhe pagat më të ulëta të punonjësve. Të dhënat e Institutit të Statistikave konfirmojnë se eksportet e tekstileve dhe këpuçëve ndaj Gjermanisë janë rritur vazhdimisht nga viti 2007 e në vazhdim. Në 2010-n, eksportet u rritën rreth 20% krahasuar me një vit më parë.

Ndërkohë, në seminarin e zhvilluar, eksperti gjerman Wolfgang Weis, vuri në dukje se industria e fasonit në Shqipëri ka sot ndër kostot më të ulëta të fuqisë punëtore në të gjithë rajonin, 0.06-0.07 euro/min. Në të njëjtin nivel me vendin tonë renditet edhe Maqedonia, me një kosto 0.06-0.08 euro/min.


"Por megjithëse në Serbi, kostoja e fuq-

isë punëtore është më e lartë (0.09-0.1 euro/min), atje qeveria ka ndërmarrë iniciativa shumë nxitëse për sektorin. 'Benetton', kompani italiane, përlogarit të ketë marrë mbi 30 milionë euro me hapjen e fabrikës së saj në Serbi nga qeveria serbe, sepse ajo paguan kompaninë për çdo të punësuar të ri, rreth 3000 euro", tha z. Weis.

Ndërkohë, sipas ekspertit gjerman, kompanitë shqiptare të fasonit duhet të vijnë në investojnë në industri dhe mbi të gjitha të organizohen së bashku, në formën e klasterit, për të përballuar porosi dhe kërkesa të mëdha që mund të vijnë nga kompani europiane.

Një element shumë i rëndësishëm ku duhet të zhvillohen kompanitë është tregu vendas. "Ndërmarrjet duhet ta kenë prioritet furnizimin e tregut vendas me veshje, d.m.th orientimin drejt tij, sepse kanë mundësi shumë të forta që të konkurrojnë importet nga Europa apo nga Kina", tha Weis. ■

Eksportet e Testileve drejt Gjermanisë



KOSTO E PAGAVE (PËRJASHTUAR TRANSPORTIN)

Shteti	euro/min
Bosnjë	0,08 – 0,09
Rumani	0,09 – 0,10
Ukrainë	0,07 – 0,08
Shqipëri	0,06 – 0,07
Bullgari	0,09
Serbi	0,09
Maqedoni	0,06 – 0,08
Burimi: GIZ	